

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6568
E premte, 25 mars 2022
çmimi 0.40

Ish-komandanti i NATO-s:
23 vjet më parë bëmë gjënë e
duhur për popullin e Kosovës

FAQE 3



TË ENJTEN NË HAGË ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E RADHËS PËR
ECURINË E ÇËSHTJES NË RASTIN KUNDËR HASHIM THAÇIT,
KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

FAQE 4-5

MBROJTJA E ISH-LIDERËVE TË UÇK-së: PROKURORIA PO SHËRBEHET ME MATERIALE TË UDB-së



Mbrojtja e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ka fajësuar të enjten Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë për fshehje të dokumenteve shfajësuese. Në seancën statusore kundër ish-krerëve të UÇK-së, avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, ka akuzuar ZPS-në se ka marrë shumë informacione dhe dokumente nga Shërbimi Inteligent i Serbisë (UDB-a). Mbrojtja e Thaçit ka shprehur shqetësimin për taktikat e prokurorisë, e cila po zvarrit dorëzimin e dokumenteve. Mbrojtja ka shprehur dyshimin se këto vonesa po krijohen për ta zvarritur fillimin e procesit gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së

“Epopoja e Dukagjinit” bëri krenar kombin shqiptar

FAQE 5



KOSOVA SOT DITË ZIE PËR MADELEINE ALBRIGHTIN

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

**BACA ADEM DEMAÇI KA
KËRKUAR AQ SA NA KA
TAKUAR, ASGJË MË TEPËR!** F.3

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



**FALEMINDERIT
UKRAINË!** F.2

Muhamet
MAVRAJ



AKTUALE

**VALË E RE SANKSIONESH
AMERIKANE NDAJ POLITIKANËVE
DHE OLIGARKËVE RUSË** F.2

**FOL, IKD DHE GLPS KËRKOJNË QË
PËRZGJEDHJA E KRYEPROKURORIT
TË KTHEHET NË PIKËN ZERO** F.6

EKONOMI

**AMBASADORI GJERMAN
KONFIRMON INVESTIMIN PREJ
60 MILIONË EUROSH PËR ENERGI
DIELLORE NË KOSOVË** F.8

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS:
MBYLLET PËR TRI DITË RRUGA
VUSHTRRI - SMREKONICË** F.8

SPORT



**KOSOVA SHKATËRROI
BURKINA FASON,
GIRESE DEBUTON ME FITORE** F.10

Faleminderit Ukrainë!



Muhamet MAVRAJ

Që një muaj rezistenca në Ukrainë më ka mbajtur të interesuar për dhe rreth saj deri në njëzet orë në ditë. Shkurtimisht:

- Bota ka një model të rezistencës kolektive. Ka Ukrainën! Ajo ngjalli disa vlera të vdekura të njerëzimit. Liria dhe dinjiteti mbi gjithçka! Demagogët tanë dikur na flisnin për vetëvrasje kolektive dhe na luftonin pa zgjedhur

mjete.

- Ukraina ka një lider të veprës dhe bota ka një lider të regjur përballë Rosisë, Bidenin, që po organizon rezistencën botërore dhe po konkretizon izolimin rus;
- Bota duhet t'i rishkruajë disa rregulla, pa Rusinë, dhe ta dënojë në rendin e modifikuar. Të sotmet i ka grirë Rusia me gjenocidin e saj sistematik;
- Rusia është faktor i çmitizuar

tashmë, frikë e çmitizuar, nuk po i mbledh as kufomat e veta rrugëve. Ka në dorë vetëm shantazhin bërthamor, tashmë banal;

- Propaganda shtetërore e dërgon kombin e dehur në humnerë. Fatura esëll do të vijë e rëndë për, së paku, një brez;
- Evropa, Kosova, shqiptarët dhe të tjerët e panë veten çfarë janë pa Shtëpinë e Bardhë. Strategët e mashtrimeve

populiste, herët a vonë, dalin qesharak, sepse nuk u rezistojnë provave që i sjell koha;

- Kursi serb po përjeton ditët më të zeza, diskreditim kolosal;
- Gjykata Speciale në Hagë, si aset rusoj-gjerman, është absurd epik aq sa do të ishte një gjykatë kundër hebrenjve ose ukrainasve sot.

Faleminderit Ukrainë!

Udhëheqësit perëndimorë kujdesen edhe për sigurinë e Ballkanit

BRUKSEL, 24 MARS - Në katër samitet e mëdha që u zhvilluan të enjten në Bruksel, e ku agresioni i Rosisë kundër Ukrainës ishte tema kryesore, është folur edhe për situatën në Ballkanin Perëndimor.

Pjesë e këtyre samiteve ishte edhe presidenti i ShBA-së, Joe Biden. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i ka përmendur në konferencë për shtyp edhe Bosnjë e Hercegovinën dhe Gjeorgjinë, duke thënë se aleatët duan që këto shtete ta forcojnë qëndrueshmërinë e tyre, sovranitetin dhe integritetin territorial.

Ndërkaq presidenti i Kroacisë, Zoran Millanović, ka thënë, pas samitit të NATO-s, se në fjalimin e tij ka qenë i vetmi që i ka përmendur edhe Kosovën dhe Serbinë. "Është përmendur rajoni, Moldavia dhe Gjeorgjia, Bosnjë e Hercegovina, e cila na qenka e rrezikuar, por askush nuk e përmendi Serbinë dhe Kosovën. Serbia është një shtet i

cili nuk është krah lindor, është praktikisht në Evropën qendrore. Ajo pas pak ditësh i ka zgjedhjet dhe e kam përshtypjen se për një kohë të gjatë është në një krizë të identitetit dhe vështirë po e kuptojnë se ajo [Serbia] për Rusinë është vetëm një fusnotë. Për neve, NATO-n dhe BE-në, e posaçërisht pasi Serbia është duke negociuar anëtarësimin në BE, është partnere e NATO-s, të jetë vend stabil dhe të ketë perspektivë të qartë perëndimore. T'i ofrohet ajo në mënyrë më të qartë në këto rrethana. Dhe nëse ata e kuptojnë mirë, e nëse jo, jo. Por ky është një rast, i cili kursesi nuk duhet të humbet, e ata të vendosin vetë", ka thënë Millanović, duke shtuar se Kosova, për fat të keq, ende nuk është njohur nga katër shtetet e NATO-s, për arsye të cilat qëmoti janë të pakuptimta, të vjetërsuara nëse fare kanë qenë ndonjëherë valide. "Kam bërë ftesë në njërin anë për dialog më serioz me Serbinë, që këtu nuk ka qenë për askënd në fokus por, në



anën tjetër, paralelisht ta integrojmë më në fund", ka thënë presidenti i Kroacisë, Zoran Millanović, pas përfundimit të samitit të NATO-s. Sipas burimeve diplomatike në Bruksel, pritet që përkushtimi për

bashkëpunim trans-atlantik ta përfshijë edhe vazhdimin e punës së përbashkët në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Si në BE, ashtu edhe në NATO, disa herë kanë tërhequr vërejtjen për kujdes në rajonin e Ballkanit për

të parandaluar që lufta në Ukrainë të ketë ndikim negativ në rajon. Shqetësimi më i madh ka qenë për situatën në Bosnjë e Hercegovinë, por edhe për raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Britania do t'ia dërgojë 6 000 raketa ushtrisë ukrainase



LONDËR, 24 MARS - Kryeministri britanik Boris Johnson ka thënë se shteti i tij do të dërgojë 6 000 raketa shitesë dhe ndihmë financiare në vlerë të 33 milionë dollarëve për ushtrinë e Ukrainës, e cila është duke luftuar pushtimin nga ana e Rosisë. Johnsoni i ka bërë këto deklarata në prag të nisjes së samitit të NATO-s dhe atij të shtatë vendeve më të industrializuara

(G7) i cili mbahet në Bruksel. "Mbretëria e Bashkuar do të punojë me aleatët tanë për ta rritur mbështetjen ushtarake dhe atë ekonomike për Ukrainën, duke forcuar mbrojtjen në luftë", ka thënë Johnsoni. "Ne nuk mund të rrimë duarkryq tekta Rusia i bën pluhur qytetet dhe qytezat ukrainase", ka thënë Johnson. Sipas zyrës së tij, Johnsoni do të kërkojë nga aleatët e Perëndimit

në samitet e Brukselit, që ta rritin peshën e vendimeve të tyre ndaj Moskës. Ky njoftim vjen pasi presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka bërë thirrje qytetarëve në gjithë botën që të dalin në rrugë dhe të protestojnë për pushtimin e Ukrainës nga ana e Rosisë. "Dilni me simbolet ukrainase për ta mbështetur Ukrainën, për ta mbështetur lirinë, për ta mbështetur jetën", ka thënë

Zelensky në një videoadresim në gjuhën angleze. Presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Ai ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në shumë vende të botës. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

Valë e re sanksionesh amerikane ndaj politikanëve dhe oligarkëve rusë

UASHINGTON, 24 MARS - Shtetet e Bashkuara kanë vendosur sanksione ndaj më shumë se 400 politikanëve, oligarkëve dhe kompanive ruse për pushtimin e paprovokuar të Ukrainës nga ana e Rosisë. Departamenti Amerikan i

Thesarit ka thënë më 24 mars se ka zgjeruar listën e të sanksionuarve, duke përfshirë kompani ruse të mbrojtjes, 328 anëtarë të Dumës Shtetërore dhe shefin e institucionit më të madh bankar në Rusi, Sberbank. "Sot ky është vendimi i fundit për të

vendosur kosto të rëndë ndaj Federatës Ruse për luftën e paligjshme dhe të pabazë kundër Ukrainës", ka thënë Thesari Amerikan. "Ky vendim është i lidhur me veprime të ngjashme të marra nga Bashkimi Evropian,

Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja dhe reflekton unitetin e vazhdueshëm për ta mbajtur presidentin rus, Vladimir Putin përgjegjës për luftën", ka thënë ai. Në listë përfshihet shefi i Sberbank, Herman Gref, i cili ka qenë njeri i afërt me Putinin prej



viteve 1990. Në deklaratë është thënë se do të ngrihet prona e të gjithë të sanksionuarve në Shtetet e Bashkuara.

KOSOVA SHËNOI 23-VJETORIN E BOMBARDIMEVE TË NATO-S

Ish-komandanti i NATO-s: 23 vjet më parë bëmë gjënë e duhur për popullin e Kosovës

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten seancë solemne me rastin e 23-vjetorit të fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s mbi caqet policore dhe ushtarake serbe. Përmes një videomesazhi gjenerali i pensionuar amerikan, ish-komandanti i NATO-s, Wesley Clark, e ka uruar Kosovën për këtë ditë. Ai para deputetëve ka theksuar se 23 vjet më parë NATO-ja ka bërë "gjënë e duhur për popullin e Kosovës"

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 MARS - Në 23-vjetorin e intervenimit të NATO-s mbi caqet ushtarake dhe policore serbe, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, përmes një videoadresimi u është drejtuar qytetarëve. Në këto 23 vjet Osmani ka thënë se Kosova ua ka dëshmuar aleatëve se ndërhyrja nuk ishte thjesht një gjest njerëzor e fisnik, por ishte veprimi i vetëm i mundshëm. "Sot edhe një herë shohim se si shkelet demokracia dhe vritet liria. Pikërisht sot, më 24 mars, NATO është mbledhur për të diskutuar për agresionin ushtarak rus kundër Ukrainës. Pamjet rrëqethëse të sulmeve ndaj civilëve të pafajshëm ukrainas janë përkujtues i rëndë e i vështirë i një të kaluarë të errët për popullin tonë", ka deklaruar Osmani.

Të enjten Kuvendi i Kosovës në një seancë solemne ka shënuar 23-vjetorin e fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s mbi caqet policore dhe ushtarake serbe. Fillimisht deputetët e Kuvendi të Kosovës me një minutë heshtje kanë nderuar ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, e cila ka vdekur më 23 mars, në moshën 84-vjeçare. Në seancë, përmes një videomesazhi, gjenerali i pensionuar

amerikan Wesley Clark e ka uruar Kosovën për këtë ditë. Ai ka theksuar se 23 vjet më parë NATO-ja ka bërë "gjënë e duhur për popullin e Kosovës".

Clark ka qenë komandant i përgjithshëm i forcave evropiane të NATO-s në kohën e ndërhyrjes në Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ), e cila ka nisur më 24 mars 1999 dhe ka përfunduar më 10 qershor 1999. "Jam posaçërisht shumë krenar për të gjithë ju në Kosovë për demokratizmin që keni bërë për zhvillimin ekonomik sfidues që keni ndërmarrë dhe jam veçanërisht mirënjohës për miqësinë e jashtëzakonshme që keni treguar ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka thënë ai.

Clark ka thënë se vëmendja aktualisht është e fokusuar në Ukrainë, por është duke punuar shumë për t'u siguruar që fokusi të mbahet në Kosovë. "Ju ende keni nevojë për ndihmën tonë, ne e dimë këtë, e vlerësojmë atë. Ne ju duam dhe duam që ju të keni më të mirën për demokracinë tuaj dhe për secilin prej jush, për jetët tuaja si anëtarë të komunitetit perëndimor. Ne do t'ju përcjellim juve dhe do të bëjmë gjithçka që mundemi për t'ju mbështetur", ka deklaruar Clark.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se 24 marsi 1999



pati sjellë shpresë, por edhe ankthe e tmerre në shtëpitë e shqiptarëve. "Hakmarrja e Sllobodan Millosheviqit ishte e fuqishme", ka thënë Kurti, duke shtuar se "NATO ndërhyri në Kosovë për arsye të qëllime humanitare, për të shpëtuar një popull nga shfarosja. Ishte ndërhyrje legjitime sepse Millosheviqi nuk shprehte gatishmëri për t'i përmbushur kërkesat dhe detyrimet që burojnë nga rezolutat në OKB dhe nuk hiqte dorë nga operacionet ushtarake dhe nga politika e spastrimit etnik. Në përvjetorin e 23-të të ndërhyrjes së NATO-s, në anën e drejtësisë i kishim popullin dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. E nga jashtë, në anën e drejtësisë, kishim ish-sekretaren amerikane të Shtetit, Madeleine Albright", ka deklaruar Kurti.

Kurti ka pohuar se lufta në Ukrainë është ajo që po e rikonfirmon se ndërhyrja e NATO-s në Kosovë ishte e drejtë, se vetëdija e popujve për liri mbetet motori më i fuqishëm i historisë.

Serbia, shtoi Kurti, edhe 23 vjet pas luftës nuk kërkon falje për krimet që ka kryer në Kosovë. "Në vend që t'i hapë arkivat shtetërore që do ta ndriçonin fatin e të zhdukurve me dhunë, pushtetarët e Serbisë arsyetojnë veprimet gjeocidale të Millosheviqit dhe e fajësojnë NATO-n për bombardime", ka thënë Kurti.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka theksuar se nuk mund të kuptohet e as të kujtohet kjo datë historike pa kryefjalën e të gjitha sakrificave dhe përpjekjeve në luftën e drejtë për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Lufta e drejtë e popullit të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ishte faktori që përcaktoi realitetin e kësaj date që ne po e shënojmë. Ishte kjo luftë dhe UÇK-ja së bashku me protagonistët e saj në mbështetje të të gjithë popullit të Kosovës ajo që bëri që NATO të vihet në mbështetje të vlerave më të larta të civilizimit perëndimor, paqes, lirisë dhe demokracisë", është shprehur Tahiri.

Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se ndërhyrja e NATO-s në Kosovë është festë dhe e tillë duhet të jetë edhe për generatat e tashme dhe të ardhshme të vendit. "Nga mbremja e 24 marsit 1999 deri në mesditën e 11 qershorit, ditën e kapitullimit të ushtrisë jugosllave, Kosova kishte marrë mbështetjen jetike ushtarake për çlirim. Pas 10

qershorit deri më sot 24 mars 2022, Kosova nga NATO kishte marrë dhe merr mbështetje për rindërtim të paqes dhe sigurisë", ka thënë ai.

Pas 23 vjetëve të intervenimit ushtarak të NATO-s, Abdixhiku shtoi se anëtarësimi i Kosovës në NATO, përveç që është qëllim madhor nacional i Kosovës dhe popullit, është përmbajtje thelbësore e kalimit nga një popull i ndihmuar në një popull i barabartë me të tjerët që ndihmon popujt e tjerë në nevojë.

Më 24 mars bëhen 23 vjet nga fillimi i sulmeve ajrore të Aleancës Veri-Atlantike kundër caqeve ushtarake policore në ish-Jugosllavi.

Pas 78 ditësh të sulmeve, bombardimet janë ndërprerë më 10 qershor 1999, me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kjo Rezolutë ishte një kompromis i pesë vendeve të përhershme anëtare të Këshillit të Sigurimit në bazë të së cilës në Kosovë vendosej një administratë e Kombeve të Bashkuara - UNMIK, e cila administronte fazën tranzitore deri në ngritjen e institucioneve vendore dhe zgjidhjen e përhershme të statusit të Kosovës. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë kishte mundësuar edhe kthimin në shtëpitë e tyre të më shumë se 800 mijë refugjatëve, personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.

Më 12 qershor 1999 filloi vendosja e rreth 50 000 ushtarëve nga 36 vende të botës, prej të cilëve 30 000 ishin nga vendet e NATO-s.

Sot, 23 vjet pas kësaj ndërhyrjeje, trupat e paqeruajtëse të KFOR-it janë në numër më të vogël, rreth 3 600 sosh. Ata janë të vendosur në pjesë të ndryshme të Kosovës me mision paqeruajtës.





TË ENJTEN NË HAGË ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E RADHËS PËR ECURINË E ÇËSHTJES NË RASTIN KUNDËR HASHIM THAÇIT, KADRI VESELIT, REXHEP SELIMIT DHE JAKUP KRASNIQIT

Mbrojtja e ish-liderëve të UÇK-së: Prokuroria po shërbehët me materiale të UDB-së

Mbrojtja e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ka fajësuar të enjten Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë për fshehje të dokumenteve shfajësuese. Në seancën statusore kundër ish-krerëve të UÇK-së, avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, ka akuzuar ZPS-në se ka marrë shumë informacione dhe dokumente nga Shërbimi Inteligent i Serbisë (UDB). Mbrojtja e Thaçit ka shprehur shqetësimin për taktikat e prokurorisë, e cila po zvarrit dorëzimin e dokumenteve. Mbrojtja ka shprehur dyshimin se këto vonesa po krijohen për ta zvarritur fillimin e procesit gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së

“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 MARS- Mbrojtja e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) të enjten ka vazhduar ta fajësojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në Hagë për fshehje të dokumenteve shfajësuese. Avokati i Hashim Thaçit, Gregory Keohe, e ka akuzuar ZPS-në se ka marrë shumë informacione dhe dokumente nga Shërbimi Inteligent i Serbisë (UDB-a). “ZPS-ja ka të bëjë me shërbimin e fshehtë serb nga i cili ka marrë shumë materiale, ka dëgjuar dhe ka marrë shumë akuza që sigurisht që nuk e gjetën rrugën deri në aktakuzë, që bashkëpunojnë me Rusinë, siç po ndodh në Ukrainë, por kjo është një gjë tjetër. Siç thashë, po merr prova materiale nga serbët që padyshim do ta cenojnë kredibilitetin e ZPS-së”, ka thënë Keohe në konferencën e radhës për ecurinë e çështjes në rastin kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe

Jakup Krasniqit. Sipas avokatit Keohe, me mijëra materiale shfajësuese janë duke u fshehur nga ZPS-ja edhe 16 muaj pas burgosjes së ish-krerëve të UÇK-së. “Nëse dokumentet janë në dispozicion të prokurorisë, ato duhet të na dorëzohen menjëherë”, ka thënë Keohe.

100 dëshmitarë që nuk ua dimë as emrat

Mbrojtja e ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në seancën statusore në Gjykatën Speciale, ka shprehur shqetësimin me taktikat e Prokurorisë, e cila po zvarrit dorëzimin e dokumenteve. Avokati i Thaçit, Gregory Keohe, ka thënë se deri më tani mbrojtja ka kërkuar mbi 1 000 dokumente të ndryshme. Sipas tij, ndonëse ishte premtuar se ato do t'i dorëzohen mbrojtjes, deri më sot kjo nuk ka ndodhur. “Ne kemi kërkuar prej konferencës së fundit mbi 1 000 dokumente. Asnjë premtim nuk është përbushur. Jemi të shqetësuar

me vonesat. Kemi shumë dëshmitarë, rreth 100 prej tyre që nuk ia dimë emrat, nuk e dimë kush janë, nuk dihen vendet. Të gjitha janë të redaktuara”, ka shtuar ai. Edhe mbrojtja e ish-krerëve të tjerë të UÇK-së janë ankuar te gjykatësi i procedurës paraprake për vonesat që janë duke u krijuar. Mbrojtja dyshon se këto vonesa po krijohen për ta zvarritur fillimin e procesit gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së.

Mbrojtja e Veselit akuzon ZPS-në: Ka orvatje serioze për t'i manipuluar provat

Mbrojtja e Kadri Veselit gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes ndaj krerëve të UÇK-së ka fajësuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) se nuk i ka nxjerrë provat shfajësuese. Avokati i Veselit, Ben Emmerson, ka thënë se të gjitha provat që gjenden në domenin publik konfirmojnë manipulimet e

provave nga autoritetet serbe. “Ka shumë prova që gjenden në domenin publik dhe të gjithat konfirmojnë manipulimin e provave nga autoritetet serbe siç është zhvarrosja e varreve masive të viktimave në kufi me Serbinë ku është gjetur një kamion”, ka thënë Emmersoni. Ai ka shtuar se këto prova janë të rrejshme, të cilat përfshijnë torturën dhe shantazhin, dhe të njëjtat nuk janë dhënë nga ZPS-ja, apo nuk i ka përfshirë në materialet shfajësuese. “Prova të rrejshme, përfshirë torturën dhe shantazhin. Të gjitha janë prova shfajësuese dhe do të duhej të ishin përfshirë te ZPS-ja. Volumi i kësaj çështjeje gjyqësore është tepër i madh. Tani kemi arritur vetëm 70 për qind të materialeve. Ka diçka që nuk shkon. U dashkan edhe shtatë muaj të tjerë për ta përfunduar. Duhet një afat këtu”, ka thënë avokati i Veselit, duke shtuar se ka orvatje serioze për t'i manipuluar provat. “Ka diçka që nuk po funksionon me efikasitet. Çdo prokuror që ndodhet dhe që

merr pjesë në këtë proces mund të jetë në dijeni të informacioneve që ka parë. Provat e forcave serbe në terren në Kosovë, që kanë pasur municione kineze për ta bërë situatën, për të vrrarë civilë, që të dukej sikur i kishte bërë UÇK-ja. Ka orvatje serioze për t'i manipuluar provat. Ky informacion dihet pse nuk na është dhënë. Ka diçka që nuk shkon këtu”, është shprehur Emmersoni. Se ZPS-ja është treguar shumë e ngathë për dhënien e provave, ka thënë edhe Andrew Strong, avokat tjetër i Veselit. “16 muaj dhe këta janë në burg e ende nuk janë zbuluar të gjitha dokumentet, vetëm 70 për qind e tyre. Edhe për 30 për qind të dokumenteve të mbetura na duhen kohë edhe pesë muaj. Prandaj na duhet një afat. Ky është një proces që po konsumon kohë. Materialet që kemi marrë së fundi janë të para tre vjetëve. Dhe këtë nuk e kuptoj. Mendojmë se diçka nuk po funksionon”, ka thënë avokati Strong.

“Epopoja e Dukagjinit” bëri krenar kombin shqiptar

Në Glogjan të Deçanit është shënuar 24-vjetori i “Epopesë së Dukagjinit”. Në shënimin e kësaj dite kanë marrë pjesë personalitete të shumta nga jeta politike dhe ushtarake, por jo edhe liderët institucionalë. Nga të pranishmit është thënë se 24 marsi i vitit 1998 ka bërë krenar kombin shqiptar. Edhe në këtë përvjetor është vërejtur mungesa e ish-drejtesve të UÇK-së, të cilët gjenden në Hagë, duke shpresuar që vitin tjetër ata të jenë të pranishëm në Glogjan

GLLOGJAN, 24 MARS (ER) - Personalitete të shumta nga skena politike, por edhe të fushave të tjera, kanë bërë homazhe të enjten në Kompleksin Memorial në Glogjan me rastin e shënimit të “Epopesë së Dukagjinit” dhe fillimin e bombardimeve të NATO-s në Kosovë.

24-vjetori i betejës së Glogjanit, e njohur ndryshe si “Epopoja e Dukagjinit”, njihet edhe si fillimi i luftës frontale ndërmjet UÇK-së dhe Serbisë.

Të pranishëm në shënimin e kësaj date ishin përfaqësues të partive politike, ish-luftëtarë të UÇK-së dhe familjarë të dëshmorëve. Me këtë rast, kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se 24 marsi i vitit 1998 është data që e bën krenar të gjithë kombin shqiptar. “Në këtë qytet e këto vendbanime rilindi jeta. Lavdi kësaj dite! Lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!”, ka thënë Ramosaj.

E pranishme në këtë manifestim ishte edhe kryetarja e komunës së Preshevës, Ardita Sinani, e cila ka thënë se Glogjani i kullave të Dukagjinit u ka qëndruar besnik jo vetëm armëve, por edhe idesë për liri dhe pavarësi. “E dashur nëna Rukë, i dashur baca Rifat, i dashuri vëlla Bashkim Ramosaj, sot jam nderuar të jem para jush. Glogjani i kullave të Dukagjinit u ka qëndruar besnik jo vetëm armëve, por edhe idesë për liri dhe pavarësi. Ky vend nuk na ka harruar në kohë krizash dhe prapë u është bashkangjitur thirrjeve tona për liri. Kam ardhur këtu para jush me përlujtje më të madhe për veprën e shumë motrave dhe vëllezërve tanë bashkëluftëtarëve që luftuan edhe për Luginën e Preshevës”, ka thënë Sinani.

Ndërsa ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Agim Çeku, ka thënë se është marsi i dytë që shënohet pa qenë të pranishëm



bashkëluftëtarët e tyre të cilët gjenden në Hagë. “Më duhet të them se është ky marsi i dytë që po e shënojmë këtë ngjarje të lavdishme dhe nuk janë të pranishëm bashkëluftëtarët tanë që padrejtësisht janë në Hagë”, ka thënë Çeku.

Edhe ish-generali Daut Haradinaj ka folur për ish-krerët e UÇK-së që gjenden në Hagë. Ai ka thënë se shpreson që marsi i ardhshëm t'i gjejë edhe ata në Kosovë. “Marsi shënon ‘Epopenë e Jasharëve’ dhe shembullin si duhet atdheu. Në marsi që shënojmë sot na mungojnë bashkëluftëtarët tanë

dhe besoj që në marsin e ardhshëm të jenë të pranishëm”, ka thënë Haradinaj.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe përfaqësuesi i familjes Jashari, baca Rifat, i cili ka shprehur falënderime edhe për ShBA-në dhe NATO-n. “Sot jemi mbledhur këtu falë Zotit, NATO-s dhe ShBA-së, që t'i kujtojmë bijtë dhe bijat më të mira të popullit shqiptar”, ka thënë baca Rifat Jashari.

Homazhe në Glogjan ka bërë edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se është përherë mirënjohës ndaj të gjithë atyre që kontribuuan për lirinë e Kosovës.

Haradinaj: Çdo ditë e jetës së shqiptarëve në shërbim të atdheut

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe ish-komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë në manifestimin qendror kushtuar 24-vjetorit të “Epopesë së Dukagjinit”. Me këtë rast, Haradinaj, duke vlerësuar lart veprën e dëshmorëve të rënë në “Epopenë e Dukagjinit”, ka thënë se çdo ditë e jetës së shqiptarëve është e mbushur me heroizëm dhe atdhedashuri. “Çdo ditë e jetës së shqiptarëve është e mbushur me kujtime për heroizmin, sakrificën kulmore në shërbim të atdheut dhe kombit. Sot, më 24 mars, nderojmë Gazmendin, Himën e Agronin, dhe të gjithë ata që përjetësisht mbesin frymëzimi më i madh i dashurisë për kombin. Po ashtu, kujtojmë 24 marsin kur nisi t'i jepej fund regjimit të egër të gjenocidit dhe spastrimit etnik. Të rënëve dhe secilit që dha nga jeta e tij për atdheun dhe lirinë, faleminderit. Aleatëve tanë, të prirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, faleminderit! Faleminderit përjetësisht!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



Sot vazhdojnë takimet në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 24 MARS - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i cili është edhe kryenegociator në dialogun me Serbinë, të premtën, më 25 mars, do të zhvillojë takime në Bruksel në kuadër të procesit që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Bislimi do të takohet me të dërguarin e posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Diplomatat në Bruksel këtë takim e quajnë si “takim në kuadër

të dialogut” dhe paralajmërojnë se në të njëjtën ditë Lajçaku do të komunikojë përmes videolidhjes edhe me delegacionin e Serbisë. Por, takime midis Kosovës dhe Serbisë nuk pritet të ketë.

Sipas paralajmërimeve në Bruksel, temat kryesore të diskutimeve pritet të jenë çështja e të pagjeturve dhe ajo e energjisë. Shpesh është thënë se rreth këtyre dy temave ka një përafrim të madh dhe marrëveshja është “pothuajse punë e kryer”. Por, sipas të njëjtave

burimeve, kanë mbetur vetëm disa hollësi për t'u sqaruar.

Pala e Kosovës ka thënë se për çështje të energjisë nuk do të bisedohet më me palën serbe, por vetëm me BE-në, e cila ka marrë përsipër edhe lehtësimin e kësaj marrëveshjeje. Por, BE-ja ka mbetur të “sqarojë” me Beogradin disa çështjeje rreth kësaj teme. Në Bruksel kanë përsëritur se vendimi i Qeverisë së Kosovës për të mos lejuar mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë ka

shkaktuar pakënaqësi, por shpresojnë që ky vendim të mos ketë ndikim negativ në dialog. Por, siç ka thënë i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, BE-ja nuk do të thërrasë takim të nivelit të lartë ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pa qenë e sigurt se në atë takim nuk do të ketë rezultate konkrete.

Baca Adem Demaçi ka kërkuar aq sa na ka takuar, asgjë më tepër!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Rambujeja si pretekst për eliminimin politik të Adem Demaçit: Thuaja të gjithë politikanët në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë, si nje të kërthizës së suksesit politik, e konsiderojnë faktin se kanë kontribuar dhe e kanë nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë të cilën, për fatin tonë të mirë, Serbia nuk e kishte nënshkruar dhe për pasojë ishin bombardimet e NATO-s që e detyruan Serbinë të tërhiqej nga Kosova duke mos e trajtuar si palë humbëse për faktin se ushtria dhe policia serbe, bashkë me paramilitarët, u tërhoqën me tërë arsenalin e armatimit me të cilin kishin kryer krime të tmerrshme. Gjatë tërheqjes e që u pajtuan me Marrëveshjen Tekniko - Ushtarake të Kumanovës, po këto forca vrisnin civilë shqiptarë, morën si pengje lufte mijëra shqiptarë, dogjën me qindra-mijëra shtëpi dhe objekte të tjera. Në të njëjtën kohë plaçkitën dhe morën me vete çdo gjë që kishte vlerë. Për të gjithë ata që pranuan të shkojnë në Rambuje, pa vendosur asnjë kusht, u sigurua një vend në Kështjellën mesjetare të Rambujesë në Francë, ndërsa për kundërshtarët u sigurua një anatemi i pashembullt i shoqëruar me linçim publik duke vënë në lojë edhe personalitetet kombëtare shqiptare dhe jugosllave siç ishte rasti i Ismail Kadaresë dhe Veton Surroit. Ismail Kadare pati nxjerrë shumë zjarr dhe vrer në përpjekje ta nxjerrë nga loja Bacën Adem Demaçi si kundërshtar i amerikanëve dhe aleatëve, kurse Veton Surroi, në faqen e parë të gazetës personale, nën foton e Bacës Adem e vuri titullin: "Adem Demaçi kundër krejt botës". Hajt ta zëmë se Ismail Kadare nuk mund t'ia falim, por Veton Surroi, për shkak të së kaluarës patriotike, brez pas brezi domosdoshmërisht, nuk mund ta kundërshtojmë për vrasjen publike mediale që ia ka bërë

bacës Adem Demaçi. Kryeministri Kurti ka qenë pjesë aktive e bisedimeve për Rambujenë, shoqëruar dhe përkthyes i Adem Demaçit në takimin me Robin Kuk në Shkup në të cilin, ministri i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar, Robin Kuk, për ata që pranorin kushtet, ua ndante biletat për Konferencën e Rambujesë, ndërsa për ata që e kundërshtonin, nuk ua siguronte as udhëtimin e kthimit nga Shkupi për në Kosovë. Albin Kurti ishte dëshmitar okular i bisedës Kuk - Demaçi dhe përgjigjen që ia dha Baca duke refuzuar 8 pika të panegociueshme nga gjithsej 12, ndër të cilat e para ishte se "garantohet integriteti territorial i mbetjes së federatës jugosllave dhe sovraniteti...". Kryeministri Kurti e di këtë shumë mirë, prandaj edhe e refuzoi Rambujenë të cilën e pranoi shumica e bërthamës studentore që pastaj u vesh me pushtet, përjashtuar këtu Muhamet Mavrajn që kishte qëndrim jashtëzakonisht korrekt.

Përkundër kundërshtimit të Marrëveshjes së Rambujesë, Baca Adem Demaçi çdo ditë ka biseduar me telefon satelitor me anëtarë të delegacionit të Kosovës të krahut të luftës duke sugjeruar që të mos nënshkruhej asnjë marrëveshje që mbështetej në 12 pikat e Robin Kukut. Për çdo ditë kam qenë në banesën e Bacës dhe jam dëshmitar, ende i gjallë, për bisedat e Bacës me Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin.

Me Rugovën, Qosjen dhe Surroin nuk e kam dëgjuar asnjëherë të ketë biseduar. Çdonjëri që e ka njohur Bacën Adem Demaçi duhet ta ketë pasur të qartë se Marrëveshjen e Rambujesë, me ato 12 pika dhe 8 të panegociueshme, nuk do ta pranonte me asnjë kusht dhe me asnjë çmim. Janë përralla dhe trillime të ulëta se Baca Adem ia ka mbyllur telefonin sekretares Ollbrajt, por se këtë vazhdimisht e kanë përdorur si armë kundër Bacës. E di se Marrëveshjen e Rambujesë nuk e kanë pranuar Baca Adem Demaçi, Skender Kastrati, Albin Kurti dhe Fexhrije Shala e që kanë dhënë dorëheqje. Baca Adem ishte shumë realist për Rambujenë: Kundërshtimi i Bacës Adem e forcoi pakëz pozicionin negociues të Kosovës ani pse në delegacion kishte



mbetje komuniste dhe titiste që do të pranorin çdo marrëveshje, prandaj aq shumë e sulmonin Bacën. Merreni me mend po të pajtohej Baca Adem me këtë marrëveshje dhe po të mos të refuzonte Serbia nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, sot Kosova edhe faktikisht do të mbetej pjesë e Serbisë, me të drejtat e garantuara nga popat e Shën Exhidios që garantonin autonomi kulturore. Vlerësimi i gabuar i Serbisë dhe verbëria shoviniste e Millosheviqit, që mendoi se njëherë e mirë dhe përfundimisht do ta zgjidhte çështjen shqiptare, duke refuzuar nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, e prodhoi një situatë të re e që përfundoi me një pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën që nuk e përjashtoi praninë dhe ndikimin e Serbisë në Kosovë, përkundrazi e shndërroi Serbinë në partnere të bashkësisë ndërkombëtare për proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me Kosovën. Albin Kurti ka shumë informata për atë

kohë, mirëpo posti i amshueshëm i vë disa kufizime, objektive dhe subjektive që, përmes djegies dhe tretjes si qiriri i Naim Frashërit, të ndriçojë një pjesë të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar dhe të Kosovës. Do të ishte e tmerrshme dhe e pakthyeshme situata për Kosovën po të realizohej 12-pikëshi i Robin Kukut! Në këtë rast shqiptarët dhe Kosova do ta kishte fatin e palestinezëve dhe kurdëve që bëjnë luftë të gjatë, me shumë sakrifica për liri dhe shtet por se, as që e arritën dhe, me gjasë, ashtu do të mbetet edhe në të ardhmen. Prandaj, mos u mburrni se e keni nënshkruar një marrëveshje, përmbytësisht të dëmshme dhe të riparueshme për Kosovën po të nënshkruhej edhe nga Serbia që me garanci ndërkombëtare do ta legjitimonte mbetjen e Kosovës nën Serbi, por pranonte gabimin historik që e bëri Millosheviqi dhe Serbia me mosnënshkrimin

e kësaj marrëveshjeje që, në fakt, ishte dhurata e Zotit për Serbinë. Baca Adem Demaçi e ka vlerësuar drejt situatën rreth dhe për Rambujenë, prandaj e zgjodhi rrugën e Vetëmohimit, duke u pushkatuar pamëshirshëm nga ata që asnjëherë nuk patën problem me Jugosllavinë dhe Serbinë e që ishin të gatshëm të nënshkruanin çdo marrëveshje, pa e lexuar fare përmbajtjen. Shqiptarët fluturojnë lart, mbi majat e maleve më të larta, kurse ushejzat dhe bretkosat jetojnë dhe mbijetojnë vetëm në moçale. Largpamësia politike, njerëzore dhe kombëtare e Bacës Adem Demaçi as sot, ndonëse kuptohet, nuk pranohet nga ushejzat dhe "gjarprinjtë e gjakut" që gjenetikisht thithnin dhe thithin gjakun e shqiptarëve që luftuan dhe sakrifkuan çdo gjë për liri, shtet dhe bashkim kombëtar. Jo vetëm e dëshirueshme, por edhe e arritshme. Mund të ketë vonim, por nuk do të ketë shpëtim!

FOL, IKD dhe GLPS kërkojnë që përzgjedhja e kryeprokurorit të kthehet në pikën zero



PRISHTINË, 24 MARS - Koalicioni i OJQ-ve, FOL, IKD dhe GLPS ka kërkuar që përzgjedhja e kryeprokurorit të shtetit të anulohet pasi, sipas tyre, ky proces ka dështuar dhe se asnjë nga kandidatët nuk ka

treguar shkathtësi për këtë pozitë. Në publikimin e raportit me titull "Integriteti i procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit (raport i monitorimit dhe vlerësimit të procesit të përzgjedhjes së

Kryeprokurorit të Shtetit)", thuhet se ky proces ka dështuar dhe duhet të kthehet në pikën zero. Gjatë monitorimit të këtij procesi ata thonë se kanë parë një trajtim jo të barabartë që u është bërë kandidatëve.

Kosova sot ditë zie për Madeleine Albrightin

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka shpallur të premten, 25 marsin, ditë zie, në shenjë nderimi pas vdekjes së ish-sekretares amerikane të Shtetit, Madeleine Albright. "Zonja Albright e njohu dhimbjen e popullit tonë, sepse edhe vetë e kishte përjetuar persekutimin qysh në fëmijëri, prandaj qëndroi e vendosur kundër Millosheviqit deri në ndaljen e gjenocidit të tij në Kosovë. E përkrahi paseshtur Kosovën deri në frymën e fundit, prandaj populli i Kosovës do ta kujtojë përjetësisht", ka thënë Osmani në një deklaratë të lëshuar nga Presidenca. Flamujt shtetërorë do të ngrihen në gjysmështrizë në të gjitha objektet shtetërore të Kosovës, brenda dhe jashtë vendit. Ish-sekretarja amerikane e Shtetit,

sulmet e NATO-s mbi caqet serbe, që kanë çuar në çlirimin e Kosovës. Për punën e saj për demokraci dhe të drejtat e njeriut ajo më 2012 është nderuar me Medaljen Presidenciale të Lirisë, që është çmimi më i lartë civil në ShBA.

Për kontributin e saj për çlirimin e Kosovës, në Prishtinë, më 2019, në përvjetorin e 20 të hyrjes së trupave të NATO-s, është zbuluar busti për nder të saj.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, së bashku me kryeministrin Albin Kurti, kanë bërë homazhe të enjten te busti i ish-sekretares amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, në Prishtinë.

Kreu i Kuvendit tha se populli i Kosovës nuk do të harrojë kurrë dhe do të jetë gjithmonë mirënjohës për kontributin e jashtëzakonshëm që Albright ka dhënë për lirinë e Kosovës. "Ajo së bashku me presidentin Clinton



drejtat dhe liritë e qytetarit në republikë, orientimi i saj për demokracinë sociale dhe njohuritë e jashtëzakonshme për gjeopolitikën, e bëjnë një personalitet i cili do të kumbojë gjatë jo vetëm në politikën dhe qeverisjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e te ne në Kosovë, po edhe në shumë vende të tjera të botës", ka thënë Kurti.

Grupi i Grave Deputete nderon veprën e ish-sekretares së Shtetit, Madeleine Albright

Edhe Grupi i Grave Deputete, shoqëruar edhe nga drejtoresha e Institutit Demokratik Kombëtar (NDI), Nancy Soderberg, kanë bërë homazhe te busti i ish-sekretares amerikane të Shtetit, Madeleine Albright. Në emër të GGD-së, kryetarja Tinka Kurti ka shprehur falënderimet për veprën dhe kontributin e ish-sekretares së Shtetit dhe ndikimin që pati për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë në vitin 1999. Ajo ka thënë se nderimi që po i bëhet sot ish-

sekretares Albright është shenjë se ajo do të jetë gjithnjë në mendjet dhe zemrat e popullit të Kosovës. "Bashkë me Grupin e Grave Deputete, që është një grup i të gjitha subjekteve politike, bashkë me drejtoreshën e NDI-së, Nancy Soderberg, e cila e kishte mentore direkte të punës së saj zonzjen

Madeleine Albright, miken e madhe të Kosovës që e ndihmoi në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, shprehëm sot trishtimin për humbjen e jetës së saj dhe, po ashtu, treguam se ajo do të jetë në mendjet dhe zemrat e popullit tonë përjetësisht", ka thënë deputetja Kurti.

Ish-presidenti Thaçi, i pikëlluar për vdekjen e Albrightit

Bekim Çollaku, këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka vizituar të enjten në Hagë Thaçin dhe Kadri Veselin, nga të cilët ka përcjellë të falat e tyre më të përzemërta. Çollaku në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ish-presidenti Thaçi ishte tejet i pikëlluar nga lajmi për vdekjen e ish-sekretares amerikane të Shtetit, Madeleine Albright, me të cilën ka bashkëpunuar ngushtë për t'u dhënë fund vuajtjeve të popullit tonë për liri. "Presidenti Thaçi ishte tejet i pikëlluar nga lajmi për vdekjen e ish-sekretares amerikane të shtetit, Madeleine Albright, me të cilën bashkëpunoi ngushtë për t'u dhënë fund vuajtjeve të popullit tonë për liri", ka shkruar Çollaku. Ish-presidenti Hashim Thaçi në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës pati thënë se Albrighte përjetësisht do të mbetet heroina jonë. "Ish-sekretarja e ShBA-së, Madeleine Albright, me këmbëngulësinë e saj bashkoi dhe mobilizoi krejt botën për ta ndaluar spastrimin etnik në Kosovë. Në 20-vjetorin e lirisë sonë sekretaren Albright e dekorova me Urdhrin e Lirisë. Ajo përjetësisht do të mbetet heroina jonë!", pati deklaruar Hashim Thaçi.



Madeleine Albright, ka vdekur të mërkurën në moshën 84-vjeçare. Ajo vdiq pas betejës me kancerin, ka njoftuar familja Albright në rrjetin social "Twitter". "Ajo ishte e rrethuar nga familjarët dhe miqtë", u tha në deklaratën e familjes Albright.

Madeleine Albright ka qenë gruaja e parë e zgjedhur në pozitën e sekretares amerikane të Shtetit më 1997. Ajo ka shërbyer në këtë pozitë deri në vitin 2001 nën administratën e ish-presidentit amerikan Bill Clinton. Albright ka qenë sekretare e Shtetit në kohën kur janë kryer

ishin forca kryesore shtytëse në planin ndërkombëtar për ta ndalë gjenocidin e shtetit të Serbisë mbi popullin e Kosovës. Në një adresim që ia bëri dje popullit amerikan, presidenti Clinton e përshkroi më së miri zonzjen Albright, duke e cilësuar thesar kombëtar", ka deklaruar Konjufca. Kryeministri Kurti ka thënë se politika, diplomacia dhe historia vështirë se kombinohen në një mënyrë më të përsosur sesa te personaliteti i jashtëzakonshëm i sekretares Madeleine Albright. "Dija e saj e thellë, mendja e mprehtë, dashuria e paepur për të



Kurti thotë se bashkëpunimi i mirëfilltë rajonal ka fuqi transformuese

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 MARS - "Politikat rajonale duhet t'i heqin barrierat ekonomike, shoqërore dhe territoriale. Në këtë mënyrë rajonet mund të bëhen më garuese, ta zhvillojnë ekonominë dhe të krijojnë vende të reja të punës", ka thënë kryeministri Albin Kurti në hapje të konferencës ndërkombëtare për zhvillim rajonal.

Në këtë konferencë, të organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kryeministri Kurti ka theksuar se na duhen politika rajonale të zhvillimit në mënyrë që të promovohet solidaritet më i madh e shkurtim i pabarazive mes rajoneve.

Duke theksuar domosdoshmërinë e intervenimit të shtetit me politika rregulluese, në mënyrë që të mos kemi zhvillim të pabalancuar,

kryeministri ka thënë se na duhet bashkëpunim ndërshtetëror dhe ndërkufitar. "Integrimi në Bashkimin Evropian është proces i natyrshëm për ne dhe në përputhje me orientimin tonë shtetëror dhe vlerat tona shoqërore", ka thënë kryeministri, duke shtuar se, krahas këtij procesi, mbështetjen fuqishëm edhe Procesin e Berlinit dhe Tregun e Përbashkët Rajonal mes gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor. "Bashkëpunimi i mirëfilltë rajonal ka fuqi transformuese sepse zonat kufitare i kthen nga vende që ndajnë shtetet, në pikëtakime që i bashkojnë ato", ka theksuar kryeministri Kurti. Ai ka thënë se qytetarët në secilën anë të kufirit duan punë, drejtësi, mirëqenie dhe përparim, "e detyrë e jona është ta realizojmë potencialin e tyre duke hequr barrierat e duke i rritur mundësitë".



Ambasadori gjerman konfirmon investimin prej 60 milionë eurosh për energji diellore në Kosovë



Prishtinë, 24 mars - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka njoftuar se shteti i tij po investon mbi 60 milionë euro për energji diellore në Kosovë. Rohde në "Twitter" është shprehur se kjo po bëhet për ta

mbështetur tranzicionin botëror të energjisë. "I lumtur që po nisim investimin në energji diellore për Kosovën, me një investim prej 60.6 milionë eurosh nga Gjermania bashkë me kryeministrin Albin Kurti", ka

theksuar ai. Projekti do të financohet nga Republika Federale e Gjermanisë dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ky projekt, mes të tjerash, përfshinë ndërtimin e kolektorëve diellorë

prej përafërsisht 69 mijë metra katrorë.

Me masat për zgjerimin e rrjetit që synojnë shpërndarjen e nxehtësisë nga sistemi termik diellor, në rrjetin e ngrohjes qendrore do të kyçen deri në 12

mijë familje ose 60 mijë banorë. Po ashtu, projekti do ta shkurtojë kërkesën për energji elektrike për qëllime ngrohjeje dhe do ta rrisë cilësinë e ajrit, me rreth 40 mijë tonelata kursime të dyoksidit të karbonit në vit.

Ministria e Infrastrukturës: Mbyllet për tri ditë rruga Vushtrri - Smrekonicë

PRISHTINË, 24 MARS - Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit ka njoftuar se duke filluar nga dita e premte (25 mars 2022) deri të dielën do të bëhet mbyllja e segmentit të rrugës Vushtrri

- Smrekovicë. Sipas MI-së, mbyllja do të bëhet pasi do të zhvillohen punimet e asfaltimit të kësaj rruge. "Për shkak të zhvillimit të këtyre punimeve do të shfrytëzohet rruga alternative. Punimet

në këtë segment do të fillojnë nesër, më 25 mars 2022, me fillim nga ora 7:00 e mëngjesit dhe do të përfundojnë më 27 mars 2022 (e diel)", thuhet në njoftimin për medie.



Ukraina ndryshoi gjithçka, sido që të mbarojë lufta, Rusia ka treguar se nuk është një superfuqi



Nga Steven Philip KRAMER
"National Interest"

Filozofi francez Michel de Montaigne tha dikur me ironi: "Gjatë jetës time kam parë lindjen e disa mrekullive". Edhe ne kemi qenë dëshmitarë të disa pikave të kthesës në histori, të një mrekullie, por dhe të një sulmi djallëzor, pas së cilës na u tha se "asgjë nuk do të ishte më njëllor": fundi i Luftës së Ftohtë, dhe sulmet terroriste të 11 shtatorit.

Hegeli kishte të drejtë, bufi i Minervës fluturon vetëm pas perëndimit të Diellit. Duhet shumë kohë për të vlerësuar kuptimin historik të ngjarjeve të tilla. 11 shtatori, reagimi amerikan dhe pasojat e tij, duket të jenë të njëpasnjëshme. Në aspektin gjeostrategjik, fundi i Luftës së Ftohtë, ishte shumë më i rëndësishëm.

Megjithatë, edhe ajo periudhë rezultoi të ishte kalimtare, pasi çështjet që supozohet se ishin zgjidhur nga fundi i Luftës së Ftohtë, janë rihapur me dhunë nga pushtimi rus i Ukrainës. Tani jemi përballë pyetjes të frikshme, të cilës do të na duhen vite që t'i japim përgjigje.

Me çfarë lloj Rusie do të përballemi pas pushtimit të Ukrainës? Cili do të jetë shtrirja e saj në Evropë? A do të shkojë Evropa drejt një uniteti më të madh, madje edhe fushën e mbrojtjes? Si do të kundërpërgjigjet Kina, dhe cili do të jetë roli i saj në një mjedis ndërkombëtar të ndryshuar?

Kufijtë e Rusisë janë rrudhur dhe zgjeruar përgjatë shekujve. Herë pas here, shtetet perëndimore e kanë sulmuar, dhe nganjëherë kanë pasur frikë nga "lokomotiva ruse".

Por Rusia e ka pasur zakonisht të vështirë me mobilizimin efektiv të forcave të saj. Ajo ka qenë më e aftë në luftën mbrojtëse, duke mposhtur Karlin XII të Suedisë, Napoleon Bonapartin dhe Adolf Hitlerin, me ndihmën e gjeneralit Dimër. Por ka dështuar në raste të tjera, dhe dështimet e saj kanë shkaktuar shpesh kriza të brendshme.

Kështu Lufta e Krimesë çoi në fundin e bujkrobërisë. Lufta e viteve 1904-1905 kundër Japonisë, solli një revolucion. Ndërsa Lufta e Parë Botërore rënien e regjimit carist. Në të tria rastet, Rusia ishte e keq-përgatitur, kishte një ushtri të prapambetur dhe ndonjëherë të korruptuar, si dhe një udhëheqje politike autoritare, por të paaftë.

Pra rezultoi të ishte shumë më e dobët nga sa dukej. Si rezultat i luftës, kufijtë e saj territorialë u rrudhën. Për shembull, pas Luftës së Parë Botërore, Polonia u rikrijua kryesisht në kurriz të territorit rus, siç ndodhi edhe me shtetet baltike. Pas shembjes së komunizmit, republikat sovjetike u bënë të pavarura.

Që nga rënia e Bashkimit Sovjetik, dhe sidomos dekadën e fundit, Rusia e ka rikthyer ndikimin e saj në republikat e vjetra sovjetike. Disa nga këto shtete ishin shumë pak funksionale. Disa ishin diktatura jopopullore, të tjerat kishin mosmarrëveshje me fqinjët e tyre, dhe disa të tjera përballeshin me kundërshtimin e pakicave etnike.

Rusia ndërhyri për të shpëtuar Aleksandër Lukashenkon nga populli i tij, duke e shndërruar Bjellorusinë në një feud të tij. Putin bëri të njëjtën gjë për regjimin kazak. "Mbrotji" osetëtdhe abkazët për të dëmtuar Gjeorgjinë, e cila kishte anuar

shumë drejt SHBA-së; dhe dërgoi forcat e saj "paqeruajtëse" në një rajon të kontestuar midis Armenisë dhe Azerbajxhanit.

Por Rusia ndërhyri edhe në pjesë të tjera të botës si Libi, Afrikën Sub-Sahariane dhe Siri, duke përjetuar pak dëme anësore. Ndoshta më e rëndësishmja: pushtoi Krimenë dhe pjesë të Donbasit në vitin 2014 me një kosto të vogël nga Perëndimi. Ai mosndëshkim, duhet ta ketë bindur Putinin se mund t'ia hidhte paq edhe duke sulmuar të gjithë Ukrainën.

Por këtë herë gjërat shkuan ndryshe. Sido që të jetë rezultati përfundimtar i luftës në Ukrainë, Rusia e ka treguar veten shumë më pak se sa një fuqi e madhe. Kontrolli total i Putinin mbi shtetin rus nuk i jep atij alibi për dështimin, për mungesën e një strategjie të mirë-menduar dhe për përgatitjen e dobët ushtarake. Është e habitshme se si Ukraina është treguar shumë më e sofistikuar sesa Rusia në strategjinë, taktikat dhe armatimin e saj.

Bombardimet si formë terrori ndaj qyteteve dhe civilëve, nuk do të bindin askënd për aftësitë e Rusisë. As përdorimi i armëve kimike apo bërthamore, nuk do ta shpëtonte reputacionin e Moskës. Disa javë më parë, në fillim të Lojërave Olimpikë Dimërore, Rusia mund të pretendonte se është një fuqi e madhe e barabartë në marrëdhëniet e saj me Kinën. Tani ajo duket më shumë si një vasale e mundshme e Kinës. Ekonomia dhe sistemi financiar rus janë shkatërruar. Rusia ka ngjallur përbuzje në arenën ndërkombëtare. Edhe nëse "fiton" në Ukrainë, ajo ka humbur në të gjitha aspektet e tjera. Por Rusia nuk do të zhduket, dhe as

nuk do të pushojë së qeni një problem.

Përvoja nuk na jep besim se ajo do të ndryshojë në diçka më të mirë. Ajo që ka ndryshuar, është se Evropa është zgjuar nga ëndrra e saj për një botë paqësore të bazuar në sundimin e ligjit, dhe është rikthyer në një botë të "gjakut dhe hekurit". Është rikthyer në një botë, në të cilën NATO dhe Shtetet e Bashkuara janë ende thelbësore.

Megjithatë bazuar në veprimet e fundit të qeverisë gjermane, është e mundur të imagjinohet se Evropa s'do të ketë zgjidhje tjetër përveçse të bëhet plotësisht një fuqi e madhe, sepse në një botë të rrezikshme dhe me një fqinj të rrezikshëm si Rusia, dhe me një Amerikë që dëshiron ta kthejë vëmendjen kryesore në Azi, Evropa duhet të jetë në gjendje të mbrohet.

Modalitetet e një Evrope të tillë duhen ende të përpunohen, por për herë të parë ndryshimi duket i sigurt. Gjatë gjithë epokës moderne, Evropa ishte një kontinent i armatosur rëndë dhe i militarizuar, por ushtritë e saj ishin përballur me njëra-tjetrën. Tani ajo mund të rikthehet ndjekjes së pushtetit, por e bashkuar. Dhe kjo do të ishte diçka e re.

Një tjetër element i ri mund të jetë ndikimi i krizës së Ukrainës në politikën energjetike. Ajomund të katalizojë përpjekjet e Evropës për burimet e rinovueshme të energjisë. BE-ja e ka njohur prej disa kohësh nevojën e kalimit në forma të reja të energjisë, por gazi dhe nafta ruse ishin shumë të përshtatshme dhe me një kosto të lirë.

A mund të imagjinohet që Evropa të mbetet e varur energjitikisht nga një Rusi e rrezikshme?

Vështirë! Në fillim, ne duhet të kërkojmë burime të tjera të karburanteve fosile për të zëvendësuar naftën dhe gazin rus. Por do të ketë me siguri një përplasje midis domosdoshmërisë për të plotësuar nevojat energjetike, dhe dëshirës së unionit për të zbutur ndryshimet klimatike: energjitë alternative në një shkallë të gjerë, dhe ndoshta ato bërthamore. Ashtu si sektori i mbrojtjes, edhe energjia do të kërkojë "më shumë Evropë".

Ndërkohë, kriza e Ukrainës, paraqet një sfidë të madhe për Kinën. Nuk ka asnjë dyshim se Pekini do të perceptojë disa përfitime politike afatshkurta nga zhvendosja e vëmendjes së SHBA-së dhe botës. Nëse Kina mbetet e fiksuar pas rivalitetit të saj me Shtetet e Bashkuara, ajo mund të mbështesë Rusinë.

Por dyshohet se Kina mendon në terma afatgjatë. Rusia po dështon në Ukrainë, dhe e ka dëmtuar rëndë imazhin e saj në arenën ndërkombëtare. Nëse Kina dëshiron që të distancohet nga Putin, dhe ta paraqesë veten si një fuqi globale e mirë, ajo duhet që të ndihmojë në ndërmjetësimin e një zgjidhjeje të konfliktit.

Duke vepruar për interesat e veta, Kina mund të lehtësojë një zgjidhje për krizën e Ukrainës. Kjo mund të inkurajojë Kinën dhe Shtetet e Bashkuara të marrin në konsideratë një përmirësim të raporteve dypalëshe. Kjo do të sillte ndodhjen e të paktën një mrekullie në kohën tonë!

Shënim: Steven Philip Kramer, anëtar i Qendrës së Studimeve Ndërkombëtare "Woodrow Wilson".

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Kosova shkatërroi Burkina Fason, Giresse debuton me fitore

“Është e rëndësishme ta filloj karrierën time te Kosova me fitore. Jemi paraqitur me ekip ndryshe. Ndaj Zvicrës do të kemi ekip krejt tjetër. Dhe kjo do të na japë një ide të përgjithshme për ekipin e Kosovës. Shume me rëndësi të arrij fitoren më të lartë në ‘Fadil Vokrri’. Qëllimi ishte për t’i kënaqur. Me këtë fitore besoj se tifozët janë të kënaqur”, ka thënë Alain Giresse, përzgjedhës i Kosovës

stadiumin “Fadil Vokrri” nisi me një minutë heshtje në shenjë nderimi për ish-sekretaren amerikane dhe mikën e madhe të Kosovës, Madeleine Albright, e cila të mërkurën ndërroi jetë. “Dardanët” dhuruan spektakël në këtë ndeshje, edhe pse Giresse preferoi ta nisë lojën pa disa prej lojtarëve titullarë. Serinë e golave e nisi Fidan Aliti, në minutën e tretë pas asistimit të Zhegrovës, derisa 20 minuta më vonë epërsinë e shtoi Astrit Selmani, pas asistimit të Rashicës. Loja e mirë e Dardanëve vazhdoi edhe në pjesën e dytë, ku realizuan edhe tre gola tjetër. Mërgim Vojvoda realizoi për 3:0 në minutën e 53-të, ku sërish asistues ishte Milot Rashica. Eky i fundit në minutën e 68-të shënoi gol të shkëlqyeshëm. Ndërkaq, rezultatit përfundimtar e vendosi Toni Domgjoni në



minutën e 75-të. Paraqitje mbresëlënëse pati edhe portieri Samir Ujkani, i cili realizoi disa pritje, në mesin e të cilave edhe gjuajtjen e Tapsobas nga penalltia, në minutën e 65-të. E në këtë ndeshje debutoi edhe futbollisti i Superligës,

Lumbardh Dellova, të cilit trajneri francez ia rezervoi 20 minuta lojë. Kjo është fitorja e parë e Kosovës pas katër humbjeve dhe dy barazimeve. Ndeshjen e radhës “dardanët” e zhvillojnë më 29 mars kundër Zvicrës në Cyrih.

“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka nisur furishëm vitin 2022, duke shënuar fitore në miqësoren kundër Burkina Fasos, me rezultat bindës 5:0. Kjo ishte ndeshja e parë e “dardanëve” nën drejtimin e përzgjedhësit të ri, Alain Giresse. Trajneri i Kosovës, Alain Giresse pas ndeshjes ka thënë se ishte i kënaqur me fitoren 5:0 ndaj

Burkina Fasos. Por, ai theksoi se ndaj Zvicrës, Kosova do të paraqitet me ekip krejt tjetër. “Është e rëndësishme ta filloj karrierën time te Kosova me fitore. Jemi paraqitur me ekip ndryshe. Ndaj Zvicrës do të kemi ekip krejt tjetër. Dhe kjo do të na japë një ide të përgjithshme për ekipin e Kosovës. Shume me rëndësi të arrij fitoren më të lartë në ‘Fadil Vokrri’. Qëllimi ishte për t’i kënaqur. Me këtë fitore besoj se tifozët janë të kënaqur”, ka thënë Giresse. Ndeshja e zhvilluar në

Prishtina fiton titullin e parë dhe historik të Ligës Unike



PRISHTINË, 24 MARS - Prishtina ka mundur Penzën me rezultat 65:66 (21:17, 12:24, 10:12, 22:13), në finalen e Ligës Unike për femra. Ky ishte edicioni i parë dhe historik i kësaj gare te femrat, duke shkuar në klubin bardhekaltër. Në çerekun e parë skuadra pejane për një nuancë ishte më e mirë, ku epërsinë më të lartë e kishte gjashtë pikë, 21:15, ndërsa kjo pjesë përfundoi 21:17. Por, prishtinaset rikthehen shpejt në periudhën e dytë, ku ishin më të mirë me epërsi të dyfishtë. Bardhekaltret kaluan fillimisht në epërsi 23:24, e më pas ngritën

epërsinë në shtatë pikë, 29:36, kurse pjesa e parë përfundoi 33:41. Perioda e tretë ishte me e baraspeshuar dhe u karakterizua me mbrojtje të fortë nga të dy skuadrat, duke bërë që të shënohen vetëm 22 pikë nga të dy skuadrat, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 43:53. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë shumë interesante, ku skuadra pejane nuk dorëzohet dhe dy minuta nga fundi afron rezultatit në 61:63, e më pas edhe 65:66, por pa arritur të bëjë më shumë dhe Prishtina fiton edicionin e parë të Ligës Unike.

MVP është shpallur Stasha Carey, që e përfundoi ndeshjen me 15 pikë e 16 kërcime, çmim të cilin e ndau nënkryetarja e Komunës së Prishtinës, Donjeta Sahatçiu, ndërsa medaljet i kanë ndarë Elvira Dushku, anëtare e Bordit Drejtues të Ligës Unike, Granit Rugova, Drejtor i Sportit në Komunën e Prishtinës, Linda Shala nënkryetare e FBK-së dhe Blerim Vuniqi, anëtar i Bordit Drejtues të Ligës Unike. Ndërkohë, trofeun e Kupës, kapitenes së Prishtinës, Arbnore Bytyqi ia dorëzuan kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe kryetari i FSHB-së, Avni Ponari.

Anderseni emërohet përzgjedhëse e Kosovës në konkurrencën e femrave

PRISHTINË, 24 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës e ka paraqitur të enjten përzgjedhësen e re të Përfaqësueses së Kosovës në konkurrencën e femrave, suedezen Karin Anneli Andersen si dhe stafin e saj përcjellës. E pranishme në këtë konferencë ishte edhe ambasadorja suedeze në Kosovë, Karin Hernmarck Ahliny, presidenti Agim Ademi,

anëtarja e KE-së, Vjollca Krasniqi dhe drejtori teknik Albert Bunjaki. Përzgjedhësja Andersen theksoi se është e nderuar që iu ka besuar drejtimi i Kosovës dhe premtoi se do të punojë me përkushtim së bashku me kolegët e saj, Nisse Jansson dhe Katarina Olsson. “Shpresoj se do të kontribuojmë me përvojën tonë të përparimi i futbollit të Kosovës. Është një sfidë e

madhe, por është nder për mua të jem në gjendje të kontribuojë në zhvillimin e futbollit të femrave në Kosovë. Do të mundohem të kemi një start të mirë, por nuk do të jetë lehtë për shkak se përballë kemi Norvegjinë dhe Belgjikën. I kam shikuar lojtaret, ndeshjet dhe kundërshtarët. Ne do të punojmë dhe besoj se do të jemi gati për t’i përmirësuar gjërat”, ka thënë Andersen.



Pedri: Reali më kishte refuzuar, por sot jam lojtar i Barcelonës

Ylli i Barcelonës, Pedri, ka zbuluar se ai doli të provohej te Real Madridi disa vjet më parë. Pedri u stërvit tri ditë me Realin dhe nëse gjërat do të kishin shkuar mirë, ai me siguri nuk do të ishte sot një lojtar i

Barcelonës. "Shkova te Real Madridi dhe ditët e para nuk mund të stërvitesha pasi fusha ishte e mbuluar me borë. Më pas u stërvita disa ditë. Pasi më panë se si luaja, më zbritën në ekipin B dhe në fund më thanë

që nuk kisha nivelin për të qëndruar te ekipi i Real Madridit. Kjo gjë më bëri keq, të jem realist, kështu që fillova të punoj fort për të pasur një të ardhme. Tani jam aty ku dua të jem, te Barcelona. Nuk e kam

takuar kurrë më personin të cilin më tha që nuk kisha talent për të luajtur me Realin, por do të doja t'i thosha se tashmë luaj për Barcelonën dhe jam shumë i lumtur", u shpreh Pedri për "El Partidazo de Cope".



Liria do të përfundojë në menaxhim privat

PRIZREN, 24 MARS - Klubi i Futbollit Liria shumë shpejt mund të shohë dritë. Në fakt, një prej klubeve më të vjetra dhe më të famshme në futbollin e Kosovës mund të përfundojë në menaxhim privat. Klubi prizrenas njofton se komisioni për dhënie në menaxhim e ka dhënë pëlqimin për nisjen e procedurave në lidhje me të interesuarit e mundshëm për dhënie në menaxhim privat të klubit.

Komisioni i dalë nga kuvendi i klubit përbëhet nga Qemal Krasniqi, Nehari Toska, Lulzim Ibri, Durak Thaçi, Skender Kapra e Erxhan Dana. "Vendimi u votua unanimisht nga komisioni, i cili tash i ka të gjitha kompetencat, në ndjekje të procedurave drejt dhënies së klubit në menaxhim privat. Komisioni shpejt do t'i paraqesë kushtet që duhet t'i



përbushin të interesuarit për të ardhmen sa më të mirë të klubit. Unanimisht anëtarët e pranishëm u pajtuan që KF Liria ta përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për thirrjen publike, e cila do të bëhet javën që vjen. Të

drejtë ofertimi kanë të gjithë të interesuarit", ka njoftuar klubi prizrenas. Aktualisht Klubi i Futbollit Liria, njëjtë si një pjesë tjetër e klubeve, është nën menaxhim të komunës së Prizrenit.

Broja: Nuk kemi frikë nga Spanja, kërkojmë fitore

TIRANË, 24 MARS - Në prag të sfidës miqësore të Shqipërisë ndaj Spanjës në Barcelonë, e cila do të zhvillohet të shtunën, në konferencën e zakonshme përpara kësaj sfide është shfaqur sulmuesi i Southamptonit, Armando Broja, i cili analizoi gjendjen e ekipit kuqezi. "Jemi gati fizikisht si ekip. E dimë që do të jetë e vështirë me Spanjën. Jemi duke u stërvitur mirë dhe shpresojmë të fitojmë ndaj iberikëve. Në futemi në fushë për ta fituar ndeshjen. Kemi ekip të mirë dhe të fortë. Nuk ia kemi frikën asnjë ekipi. Miqësoret janë të mira për të marrë përvojë. Shpresojmë të fitojmë ndaj Spanjës. Kam luajtur kundër dy mbrojtësve të Spanjës dhe do të jetë një ndeshje e vështirë sepse ata janë të mirë, por edhe ne nuk jemi pa kualitet. Jam rritur më shumë si djalë. Kam mësuar më shumë te Southamptoni. Duhet të vazhdoj kështu përpara për të luajtur për ekipin dhe për vete", ka thënë Broja.

"Te Southamptonii ka qenë e vështirë. Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe me këmbë në tokë arrihet gjithçka. Duhet ta fitojmë ndeshjen. Kemi ekip të fortë dhe ne nuk kemi frikë. Duhet të luajmë me taktikat tona dhe miqësoret janë të mira për të marrë përvojë. E prisja dhe nuk e prisja që ta nisja kështu në Premierë Ligë. Besoja se do të ecte mirë sepse isha me



këmbë në tokë. Ka ende dy muaj për të përfunduar sezoni dhe shpresojmë që të ecim në këtë gjendje", ka shtuar sulmuesi kuqezi. Në fund Broja ka folur edhe

për të ardhmen, duke bërë me dije se është i fokusuar vetëm te Southamptoni, por për të ardhmen thotë se nuk e di se çfarë do të ndodhë.

SHKURT

Japonia kualifikohet për në Kupën e Botës

Australia mbetet jashtë Botërorit "Katar 2022", duke u mposhtur me rezultatin 0-2 nga Japonia, në duelin final për të siguruar një biletë për ngjarjen e madhe. Australianët ishin favoritët kryesorë që në fillim të eliminatorëve për të prerë një biletë për në fazën finale të kompeticionit më madhor të futbollit në nivel kombëtaresh. Golat për ekipin japonez u shënuan nga Mitoma, i cili realizoi dy herë, në minutën 89 dhe 90+4-t. Nga Azia në Kupën e Botës do të përfaqësohen nga Arabia Saudite dhe nga Japonia.

Pogba po kërkohet nga dy klube të Premierë Ligës

Paul Pogba mund të largohet nga Manchester Unitedi në verën që vjen. Mesfushori francez nuk është i kënaqur me pesë vitet e kaluara në "Old Trafford". Kampionit të botës me Francën do t'i skadojë kontrata në fund të sezonit dhe ai po e kërkon një sfidë të re. Kohë më parë flitej se interesim për mesfushorin kreativ kanë shprehur ish-klubi i tij, Juventus dhe dy klube të tjera, Real Madridi dhe Paris Saint-Germaini. Por, mediumi britanik "The Sun" njofton se tash në garë për Pogban kanë hyrë edhe dy klubet e tjera angleze, Newcastle United dhe Aston Villa. Lojtari nuk e ka përjashtuar mundësinë që ta vazhdojë karrierën në Premierligë. Por, ai e do një klub me të cilin mund të fitojë trofe, e për momentin asnjëri nga këta dy klube nuk mund t'i sigurojë një gjë të tillë.

Usyk largohet nga Ukraina, nis përgatitjet për meçin ndaj Joshuas

Kampioni i botës në peshat e rënda, Oleksandr Usyk, është larguar nga vendlindja e tij, Ukraina, për t'u përgatitur për revanshin me Anthony Joshuan, shkruan BBC. Prilli ishte përmendur si një datë e mundshme për revanshin, por kërkimi i Joshuas për një trajner të ri dhe bisedimet e zgjatura me kampionin e WBC-s, Tyson Fury, e kanë shtyrë këtë meç. Usyk është vetëm një nga disa boksierët ukrainas që kishte dalë në mbrojtje të atdheut. Kampioni i botës në tri peshat, Vasiliy Lomachenko, 34 vjeç, gjithashtu ka kapur armët, ndërsa vëllezërit Vitali dhe Wladimir Klitschko, të dy ish-kampionë të botës në peshën e rëndë, janë gjithashtu në Kiev.

Pensionohet Defoe

Jermain Defoe është pensionuar nga futbollin aktiv. Defoe pati një karrierë të pasur, kryesisht në futbollin anglez, me paraqitjet e tij te Tottenham Hotspuri që kulmuan në karrierën e tij. Anglezi e nisi karrierën te West Ham Unitedi para se të kalonte te Tottenhami. Pastaj Defoe u transferua te Portsmouthi, për t'u rikthyer më pas përsëri te Tottenhami, ku luajti nga sezoni 2008 deri më 2014. Defoe luajti edhe në ShBA, me skuadrën e Torontos, por vendosi të kthehej përsëri në futbollin anglez, ku u aktivizua me Sunderlandin e Bournemouthit. Ai luajti edhe me fanellën e Rangersit në Skoci. Lojtari është paraqitur edhe me kombëtaren e Anglisë që ishte pjesëmarrës në Kupën e Botës 2006, Kupën e Botës 2010, 2014 dhe Euro 2012.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Xhema 4F" Sh.p.k. Piranë Prizren, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në Krushë të Vogël komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.04.2022 në ora 11:30 në lokalet e kompanisë "Xhema 4F" Baze Betoni në Krushe të Vogël komuna e Prizrenit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Xhema 4F" Sh.p.k. Piranë Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në Krushë të Vogël komuna e Prizrenit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Xhema 4F" Sh.p.k. Piranë Prizren për bazën e betonit në Krushë të Vogël komuna e Prizrenit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Renelual Tahiri" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit te betonit në Lubizhdë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.04.2022 në ora 10:00 në zyrat e kompanisë Renelual Tahiri sh.p.k e cila gjendet në rruga e Jonit nr. 92/2 në Prizren, do të organizohet debat publik nga Kompania "Renelual Tahiri" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit te betonit në Lubizhdë komuna e Prizrenit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmpha1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Renelual Tahiri" Sh.p.k Prizren për bazën e prodhimit te betonit në Lubizhdë komuna e Prizrenit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit: **044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Edon Xhyliqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.
- ▶ Ramiz Shehu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Selim Hashani shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Miradije Qafleshi shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Betim Cono shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizreni.
- ▶ Arbi Tara nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.U "Fehmi Agani" nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Shpetim Salihi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLE " Hasan Prishtina".
- ▶ Fatlum Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesat e SHMLE " Hasan Prishtina".
- ▶ Ramadan Xhemajli shpalle te pavlefshme dëftesat e SHMLE " Hasan Prishtina".
- ▶ Faruk Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesat e SHMLE " Hasan Prishtina".
- ▶ Valdet Zeqiri shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 9-te te shkollës fillore " Shemsi Ahmeti" Shupkovc
- ▶ Almir Lubja nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u. "Yll Morina" nga kl. I-V dhe VI-IX.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

